



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2018

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9920,
DATË 19.05.2008, “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 113, pika 1, shkronja “ç”, 155 dhe 157, pika 3, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 40, “Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare”, në fund të pikës 1, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Një person fizik me të njëjtin numër të identifikimit personal regjistrohet vetëm një herë nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Atij i lind e drejta të regjistrohet dhe të pajiset me një NIPT/NUIS të ri nga Qendra Kombëtare e Biznesit, vetëm mbas çregjistrimit të NIPT-it/NUIS-it ekzistues.”.

Neni 2

Në nenin 43, “Përditësimi i të dhënave të regjistrimit”, pas pikës 1/1, shtohet pika 1/2, me këtë përmbajtje:

“1/2. Edhe personi fizik tregtar i pajisur me NIPT/NUIS, për çdo veprimtari të re që kërkon të regjistrojë, pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm, me qëllim identifikimin e vendndodhjes të veprimtarisë së re.”.

Neni 3

Në nenin 44, “Kalimi në regjistrin pasiv”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në fund të shkronjës “c”, të pikës 1, shtohen fjalët “... dhe paguan të gjitha detyrimet tatimore.”.
2. Pas pikës “4”, shtohet pika “4/1”, me këtë përmbajtje:

“4/1. Kalimi në regjistrin pasiv të tatimpaguesve persona fizikë dhe juridikë, nga Qendra Kombëtare e Biznesit, bëhet duke verifikuar më parë pagimin e detyrimeve tatimore nga ana e tyre. Verifikimi në administratën tatimore bëhet në rrugë elektronike brenda të njëjtës ditë pune.”.

3. Pika 7 ndryshon, me këtë përmbajtje:

“7. Administrata tatimore qendrore publikon në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe përditëson mbi baza ditore listën e tatimpaguesve që janë në regjistrin pasiv.

Çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregtarë, që janë në regjistrin pasiv, konsiderohet shkelje administrative dhe dënohet, si më poshtë vijon:

- a) Për shitësin, i cili është në regjistrin pasiv, bëhet vlerësim tatimor dhe dënim, në përputhje me nenin 116 të këtij ligji;
- b) Për blerësin, vlerësim tatimor për mosnjohjen e TVSH-së së zbritshme dhe të shpenzimit.

Gjithashtu, çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit aktivë, persona fizikë apo juridikë tregtarë, me tatimpaguesit që janë në regjistrin pasiv, konsiderohet shkelje administrative dhe dënohet, si më poshtë vijon:

- a) shitësi aktiv, në përputhje me pikën 2, të nenit 128, të këtij ligji. Ky dënim nuk aplikohet në rastet kur, për arsye teknike, lista e tatimpaguesve në regjistrin pasiv nuk është përditësuar nga administrata tatimore;

- b) blerësi në regjistrin pasiv, me vlerësim tatimor të detyrimit dhe dënim, në përputhje me nenin 116 të këtij ligji.”.

Neni 4

Neni 45, me titull “Çregjistrimi i subjekteve tatimore”, ndryshon në titull dhe në përmbajtje, si më poshtë vijon:

“Neni 45 Çregjistrimi i subjekteve/tatimpaguesve

1. Subjektet/tatimpaguesit, të cilët janë regjistruar në administratën tatimore, sipas pikave 1 deri 4, të nenit 40, dhe të nenit 42, të këtij ligji, çregjistrohen nga regjistri i administratës tatimore vetëm mbas çregjistrimit të tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe/ose në Gjykatë.

Subjektet/tatimpaguesit, të cilët janë të regjistruar në administratën tatimore, sipas pikës 4.1, të nenit 40, çregjistrohen nga drejtoritë rajonale tatimore, sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.

2. Data e çregjistrimit të tatimpaguesit në administratën tatimore është data e çregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose në Gjykatë, për të gjitha subjektet që çregjistrohen pranë tyre.

Data e çregjistrimit të personave juridikë publikë apo të ngjashme me to, si dhe të institucioneve e organizatave ndërkombëtare, është data e aktit/vendimit të mbylljes nga institucioni përkatës.

Datë e çregjistrimit për subjektet/tatimpaguesit e tjerë është data e miratimit të çregjistrimit të tyre nga administrata tatimore.

3. Çregjistrimi i subjekteve/tatimpaguesve, që janë pjesë e regjistrit të Qendrës Kombëtare të Biznesit

- 3.1. Çregjistrimi i subjektit/tatimpaguesit nga regjistri i administratës tatimore fillon në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe, mbas çregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, bëhet çregjistrimi në regjistrin e administratës tatimore.

- 3.2. Qendra Kombëtare e Biznesit, me marrjen e kërkesës për çregjistrim të personit fizik, njofton menjëherë organin tatimor në rrugë elektronike mbi datën e kërkesës për çregjistrimin e tij.

Për personat juridikë, Qendra Kombëtare e Biznesit njofton statusin e shoqërisë në likuidim, dhe në vijim, kur shoqëria dorëzon raportin përfundimtar të likuidimit, dërgon në organin tatimor datën e paraqitjes së këtij raporti.

Për personat juridikë, që kryejnë çregjistrimin nëpërmjet procedurave të bashkimit apo ndarjes së shoqërive, Qendra Kombëtare e Biznesit dërgon në organin tatimor përkatës vendimin përfundimtar të miratimit të bashkimit/ndarjes së shoqërive.

- 3.3. Administrata tatimore, brenda 10 ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës për çregjistrim të personave fizikë, apo paraqitjes së raportit përfundimtar të likuidimit për personat juridikë, është e detyruar të verifikojë dhe të vlerësojë situatën tatimore të subjektit/tatimpaguesit në llogarinë e tij në kontabilitetin dhe sistemin e të dhënave që disponon. Për situatën tatimore të subjektit/tatimpaguesit, si dhe për deklaratat e padorëzuara nga ai, administrata tatimore njofton brenda këtyre 10 (dhjetë) ditëve tatimpaguesin.

Kur administrata tatimore, sipas analizës së riskut, gjykon se është e nevojshme të ushtrojë kontroll në mjedisin ku kryen veprimtarinë subjekti, ky kontroll dhe pasqyrimi i tij në situatën e tatimpaguesit nuk mund të zgjasë më shumë se 30 (tridhjetë) ditë pune.

Komunikimi me Qendrën Kombëtare të Biznesit, për detyrimet tatimore dhe deklaratat e padorëzuara të tatimpaguesit, do të bëhet në rrugë elektronike, në kohë reale, sipas marrëveshjes dypalëshe dhe protokollit elektronik të komunikimit ndërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

- 3.4. Qendra Kombëtare e Biznesit nuk mund të kryejë çregjistrimin e subjektit, në qoftë se në situatën e tatimpaguesit në kohë reale rezultojnë detyrime tatimore të papaguara të tatimpaguesit dhe deklarata tatimore të padorëzuara, si dhe në rast se ai nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit deri në momentin e mbylljes. Në raste të veçanta, kur deklaratat apo pasqyrat financiare nuk janë dorëzuar nga subjektet, komunikimi ndërmjet organit tatimor dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit mund të bëhet me postë elektronike (e-mail) ose dhe me shkresë zyrtare.
- 3.5. Nëse në situatën në kohë reale të tatimpaguesit/subjektit nuk ka detyrime tatimore të papaguara, si dhe deklarata të padorëzuara, Qendra Kombëtare e Biznesit kryen menjëherë çregjistrimin e tatimpaguesit, duke njoftuar menjëherë në rrugë elektronike administratën tatimore për datën e çregjistrimit të tij.

4. Çregjistrimi i subjekteve/tatimpaguesve që likuidohen në Gjykatë.

- 4.1. Gjykata, me marrjen e kërkesës për çregjistrim prej subjektit/tatimpaguesit, njofton menjëherë organin tatimor kompetent për regjistrimin e hapjes së procedurave të likuidimit dhe në vijim për paraqitjen e raportit përfundimtar të likuidimit. Ky njoftim bëhet edhe për personat juridikë që likuidohen dhe çregjistrohen në gjykatë sipas dispozitave të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” apo subjekteve/tatimpaguesve që hyjnë në procedura falimentimi.
- 4.2. Administrata tatimore, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës për çregjistrim në gjykatë, është e detyruar të verifikojë situatën tatimore të subjekteve dhe njofton gjykatën dhe subjektin mbi këtë situatë. Kur organi tatimor, sipas analizës së riskut, gjykon se është e nevojshme të ushtrojë kontroll në mjedisin ku ushtron veprimtarinë subjekti, atëherë ky kontroll, pasqyrimi i tij në situatën e tatimpaguesit dhe njoftimi i gjykatës nuk mund të zgjasin më shumë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike.
- 4.3. Gjykata nuk mund të kryejë çregjistrimin, në qoftë se brenda afatit të 30 (tridhjetë) ditëve administrata tatimore e kundërshton me shkrim çregjistrimin. Kundërshtimi i çregjistrimit të tatimpaguesit nga administrata tatimore tregon shumën e detyrimeve tatimore të papaguara të tatimpaguesit dhe faktin që nuk ka dorëzuar deklarata tatimore apo nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit deri në momentin e likuidimit përfundimtar.

Nëse organi tatimor nuk i përgjigjet gjykatës brenda afatit 30-ditor, gjykata çregjistron subjektin/tatimpaguesin dhe njofton në të njëjtën ditë organin tatimor dhe tatimpaguesin.
- 4.4. Kur subjekti paguan detyrimet e papaguara në kohë, administrata tatimore njofton menjëherë gjykatën dhe vetë subjektin se ai nuk ka detyrime tatimore të papaguara. Gjykata kryen çregjistrimin dhe dërgon në administratën tatimore dokumentin e çregjistrimit të subjektit, përfshirë datën e çregjistrimit.

5. Çregjistrimi i subjekteve/tatimpaguesve që regjistrohen vetëm në regjistrin e administratës tatimore, sipas pikës 4.1, të nenit 40, të ligjit, dhe që janë të regjistruara në drejtoritë rajonale tatimore me procedura të thjeshtuara, si: ambulantë, përfaqësues tatimorë, fermerë, individë etj., bëhet pranë drejtorive rajonale tatimore përkatëse, sipas procedurave të thjeshtuara të parashikuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.

6. Subjektet e regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit/gjykatë dhe në administratën tatimore çregjistrohen nga regjistri elektronik pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet tatimore, përfshirë detyrimet që lindin në rastin kur çregjistrimi kryhet me likuidim. Në rastin e falimentit, subjekti/tatimpaguesi do të çregjistrohet sipas vendimit të gjykatës me statusin “i falimentuar”.
7. Nëse pavarësisht se detyrimi tatimor për të cilin është kundërshtuar çregjistrimi është shlyer, por administrata tatimore nuk e ka tërhequr kundërshtimin, subjekti/tatimpaguesi paraqet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit apo gjykatës dokumentin që vërteton shlyerjen e detyrimeve tatimore. Në këtë rast Qendra Kombëtare e Biznesit apo gjykata kryejnë menjëherë çregjistrimin dhe njoftojnë administratën tatimore dhe tatimpaguesin.
8. Çregjistrimi i subjektit/tatimpaguesit në Qendrën Kombëtare të Biznesit apo gjykatë nuk eliminon detyrimet tatimore të papaguara dhe nuk e ndalon administratën tatimore të vlerësojë ose të mbledhë me forcë detyrimet tatimore.”.

Neni 5

Në nenin 68, “Vlerësimi tatimor”, në pikën 8, fjalët “..., me vlerë deri në 100 (një qind) lekë,...” zëvendësohen me fjalët “..., me vlerë deri në 1 000 (një mijë) lekë, ...”.

Neni 6

Në nenin 71, “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi”, pas shkronjës “ë”, shtohet shkronja “f”, me këtë përmbajtje:

- “f) tatimpaguesi me status “person fizik tregtar”, i cili, për qëllime të shmangies tatimore dhe minimizimit të detyrimit tatimor, regjistron/mban më tepër se një numër identifikimi unik të subjektit, dhe dorëzon deklarata të veçanta për çdo NIPT/NUIS.”.

Neni 7

Pas nenit 71/1, shtohet neni 71/2, me këtë përmbajtje:

“Neni 71/2

Përdorimi i metodave alternative të vlerësimit në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor

1. Në rastet kur një apo disa tatimpagues kryejnë një veprim/transaksion apo seri veprimesh/transaksionesh direkte apo indirekte me persona të tretë, ku:

- a) veprimet e ndërmarra nga tatimpaguesi deformojnë parimet e ligjit tatimor;
- b) veprimet/transaksionet nuk bazohen në parimin e vlerës së tregut;
- c) veprimet/transaksionet janë pa efekte ekonomike thelbësore;
- ç) forma e veprimit/ transaksionit nuk reflekton thelbin e tij ekonomik;
- d) evidentohen elementë të veprimeve/transaksioneve që synojnë shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore,

për përcaktimin e detyrimit tatimor, administrata tatimore nuk merr parasysh një veprim/transaksion apo një seri veprimesh/transaksionesh, të cilat, duke qenë se janë ndërmarrë me synim përfitimin e një avantazhi tatimor që vjen në kundërshtim me qëllimin e ligjit, rezultojnë fiktive në bazë të të gjitha fakteve dhe rrethanave.

2. Kur një veprim/transaksion apo seri veprimesh/transaksionesh janë në kushtet e pikës 1 më sipër, veprimi/transaksioni rikarakterizohet dhe detyrimi tatimor llogaritet në përputhje me dispozitat për vlerësimin tatimor alternativ të këtij ligji dhe ligjeve të tjera tatimore. Në këto raste, barrën e provës e ka kryesisht administrata tatimore.”.

Neni 8

Në nenin 75, “Detyrimet tatimore të paguara më tepër”, pas pikës 2, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Kompensimi nga teprica kreditore i detyrimeve tatimore brenda çdo tatimi, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, kryhet automatikisht nga sistemi informatik.”.

Neni 9

Në nenin 79, “Radha e pagesës së kontributeve dhe të detyrimeve tatimore”, në krye të pikës 1, shtohet fjalia me përmbajtje, si më poshtë vijon:

“Pagesat e kryera për çdo tatim, përveç pagesave për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, fillimisht do të shkojnë për të mbyllur detyrimet më të hershme brenda të njëjtit lloj detyrimi, në qoftë se këto detyrime nuk janë në proces apelimi, gjykimi apo në marrëveshje të pagesës me këste të detyrimeve tatimore të papaguara.”.

Neni 10

Në nenin 89, “Njoftimi dhe kërkesa për të paguar”, pika 1 ndryshon me përmbajtje, si më poshtë vijon:

- “1. Kur administrata tatimore konstaton se një tatimpagues nuk ka paguar plotësisht dhe në datën e caktuar detyrimet tatimore, ajo i dërgon atij, me postë rekomande ose në rrugë elektronike, një njoftim me shkrim, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimit tatimor. Për njoftimin dhe kërkesën për të paguar detyrimet tatimore zbatohen afatet dhe procedurat e parashikuara në nenin 69 të këtij ligji”.

Neni 11

Në nenin 90, “Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit”, në pikën 1, në fjalinë e parë, pas fjalëve “... çdo banke, ...” shtohen fjalët “... me postë rekomande ose në rrugë elektronike, ...”.

Neni 12

Në nenin 103, “Procedurat për deklarimin e detyrimit tatimor si të pambledhshëm dhe fshirja/shuarja e tij”, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Pika 7 ndryshon, si më poshtë vijon:

- “7. Pas deklarimit të pambledhshëm të detyrimit tatimor ose të një pjese të tij, organi tatimor evidenton në regjistrin kontabël detyrimet që janë deklaruar të pambledhshme në zbatim të ligjit.”.

2. Pas pikës 7, shtohen pikat 8 e 9, me këtë përmbajtje:

- “8. Fillimi i procedurës për deklarimin e detyrimit tatimor si të pambledhshëm mund të bëhet me kërkesë nga ana e tatimpaguesit ose kryesisht nga ana e organit tatimor.
9. Administrata tatimore publikon çdo vit vlerën totale të detyrimeve tatimore të deklaruara si të pambledhshme, numrin e kërkesave në total dhe numrin e kërkesave të pranuar.”.

Neni 13

Në nenin 107, “Pagesa e detyrimit tatimor, objekt ankimi”, në pikën 2, në fund të fjalisë shtohen fjalët “..., si dhe kamatëvonesat e llogaritura.”.

Neni 14

Në nenin 115, “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, pas pikës 2, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Deklarim i pasaktë konsiderohet edhe rasti kur, si rezultat i një kontrolli tatimor, bëhet rivlerësim në ulje i tepricës kreditore të tatimpaguesit. Në këtë rast tatimpaguesi penalizohet me gjobë 20 % të diferencës ndërmjet tepricës kreditore të deklaruar me tepricën kreditore që duhej deklaruar.”.

Neni 15

Pas nenit 115/1, shtohet neni 115/2, me këtë përmbajtje:

“Neni 115/2

Dënimet për mosnjohimin e ndryshimeve në lidhje me ndryshimin e pronësisë

Nëse një person juridik nuk njofton administratën tatimore lidhur me ndryshimet e pronësisë, sipas kërkesave të nenit 27/1, “Ndryshimi i pronësisë”, të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ai është përgjegjës dhe dënohet, si më poshtë vijon:

- a) Për shkeljen në rastin e pikës 3, të nenit të sipërpërmendur, 15 (pesëmbëdhjetë) për qind të vlerës së tregut të aktiveve të trajtuara si me ndryshim pronësie;
- b) Për shkeljen në rastin e pikës 4, të nenit të sipërpërmendur, 5 (pesë) për qind të vlerës së tregut të aksioneve ose interesave të ngjashme që u ka ndryshuar pronësia.

Dënimi, sipas shkronjës “b” më sipër, nuk zbatohet kur vërtetohet që personi nuk ishte në dijeni të ndryshimit të pronësisë apo nuk ka të dhëna, prova apo fakte që të besohet se personi duhet të ishte në dijeni.”.

Neni 16

Në nenin 124, “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve”, pas paragrafit të pikës 1, shtohet paragrafi i dytë, me këtë përmbajtje:

“Nëse tatimpaguesi pranon vlerësimin tatimor dhe e paguan detyrimin, gjoba, sipas paragrafit më lart të kësaj pike, zbritet me 30 (tridhjetë) për qind.”.

Neni 17

Në nenin 129, “Dënimet për tatimpaguesit, që janë banka apo institucione financiare”, në fund të shkronjës “ç”, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në çdo rast, shuma e gjobës që zbatohet nuk mund të jetë më e madhe se shuma e kërkuar për t’u bllokuar.”.

Neni 18

Në nenin 135, “Nxjerrja e akteve nënligjore”, pasi pikës 2, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1 Ngarkohet ministri përgjegjës për financat për nxjerrjen e aktit nënligjor në lidhje me procedurat dhe kriteret e zbatimit të nenit 71/2, lidhur me përdorimin e metodave alternative të vlerësimit, në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor.”.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Ky ligj botohet në “Fletoren zyrtare” dhe hyn në fuqi më 1 janar 2019.

K R Y E T A R

GRAMOZ RUÇI